

V E N D I M
Nr. 310, datë 27.6.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË
SHËRBIMIT PYJOR", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor 71 900 lekë

Zëvendësdrejtor 53 600 lekë

b) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 9 400 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 26 100 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko